Ka edhe shtëpi përdhesa prej gurri ose prej drase; të mbuluara me qeramidhe, me drasa, me pllоça, ose me kashtë. Këto janë të klasave të fundit.

Ngjitur me shtëpinë do të vesh re kosheren për misrin, nonjë a dy mullare me misërish a a me bar, nonjë kasolle, dhe një bashtulkë të mbjellë me lakra ose me të tjera barishta.

Kulla mund të ketë tre, katër, ose më tepër oda. Atje ku mungon kasollja, oda përdhese përdoret për bagëtinë. Kjo është posa hyn ke dera. Një shkallë e ngushtë të shpie në odën e burrave ku priten miqtë. Posa hyn brenda vjen ballë për ballë me oxhakun. Kemi gjetur lloj lloj formash buariu: të rumbullaktë, katrore, konike, me korniza prej gurri, etj ; kllanikë të futur në mure e të dalë; vatra prej gurri ose prej balti. Në shtëpitë përdhesa vatra ndodhet në mes dhe buariu për të hequr tymin mungon. Mi zjaret është varur poçja prej balti me një zinxhir. "Demiroxhaku" është një pjesë e vatrës edhe përdoret për të mështetur drutë mi të. Pishtari, një lloj rjete prej teli, varet nga tavani dhe shërben për të vënë pishën e ndezur që ndrit odën. Përpara vatrës mi dysheme kanë hapur një vërrushkë dhe që andej hedhin plerat që fshinë passi ngrenë sofrën.

Oda nuk ka shumë mobilja; në për këndet